



AMAP

PROGRAMI SHQIPTAR I VEPRIMIT NDAJ MINAVE




ASISTENCË PËR TË AKSIDENTUARIT NGA MINAT





Aktivitetet e projektit të PMR në Shqipëri

TË PËRGJITHSHME:

- Ndotja me mina/municione të paplasura, e cila ishte pasojë e konfliktit në Kosovë në 1999, preku zonën verilindore të Shqipërisë në Qarkun e Kukësit. Gjithashtu, municione të braktisura (AXO) janë shpërndarë në të gjithë Shqipërinë si rezultat i hapjes së depove të municioneve gjatë trazirave në vitin 1997 si dhe mbetjet nga Lufta e Dytë Botërore.
- Një sipërfaqe prej 120 km përgjatë kufirit Shqiperi-Kosovë, si dhe deri në 20 km në brëndësi të territorit shqiptar u identifikua fillimisht si zonë e ndotur nga minat dhe municionet thërmuese duke përfshirë në total një sipërfaqe prej 15,250,000 m² në 102 zona.
- 210 aksidente kanë ndodhur në verilindje të Shqipërisë, nga të cilat 238 persona janë plagosur dhe 34 të tjerë kanë humbur jetën. Gjithashtu, 686 persona janë plagosur nga municionet e braktisura (AXO) në të gjithë Shqipërinë nga 1995 deri në fund të vitit 2009.
- Rreth 30% e të aksidentuarve nga minat ishin fëmijë në kohën kur ndodhi aksidenti, ndërsa shumica e tyre janë kryefamiljarë të seksit mashkull dhe 8% janë femra.
- Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave (AMAE) është duke koordinuar dhe monitoruar aktivitetet e veprimit ndaj minave ndërsa PNUD dhe ITF kanë zbatuar projekte të ndryshme për asistencën ndaj të aksidentuarve në Shqipëri.
- Që nga viti 2001, AMAE regjistron aksidentet nga minat/UXO me anë të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Veprimit ndaj Minave (IMSMA) i cili aktualisht është duke shërbyer si një mjet informues për partnerët zbatues dhe aktorët e tjerë.



Kjo broshurë u publikua me asistencën e Bashkimit Europian dhe PNUD. Pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë në asnjë rast nuk reflektojnë opinionin e Bashkimit Europian ose Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë PNUD ose shtetet e tyre anëtare.



Programi i Asistencës ndaj të Aksidentuarve nga Minat/Municipionet e Paplasura

Një strategji gjithëpërfshirëse u formulua në vitin 2002 për të përcaktuar vizionin, misionin dhe objektivat e Veprimit ndaj Minave në Shqipëri duke përfshirë edhe Asistencën ndaj të Aksidentuarve nga Minat/UXO si një nga detyrimet e Konventës për Ndalimin e Minave Kundër Personit, të cilën Shqipëria e ratifikoi në shkurt të vitit 2000 si dhe të Konventës mbi Municionet Thërmuese, të ratifikuar në qershor 2009.

Vizioni: Rehabilitimi fizik dhe ri-integrimi ekonomik i të aksidentuarve nga minat në komunitetin ku ata jetojnë.

Qëllimi: Përmirësimi i kapaciteteve në Shqipëri në fushën e rehabilitimit fizik dhe mjekësor dhe fuqizimi ekonomik, psikologjik dhe social i të aksidentuarve nga minat në Shqipëri.

Objektivat:

- » Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve shqiptare për të prodhuar të gjitha llojet e protezave në Shqipëri deri në fund të vitit 2010.
- » Ndërtimi i kapaciteteve të kërkuara për rehabilitimin e të dëmtuarve nga sytë në Shqipëri.
- » Ri-integrimi ekonomik i të aksidentuarve nga minat përmes trajnimeve profesionale dhe krijimi i një skeme mikrofinancimi në funksion të ekonomive me bazë shtëpiake.
- » Ndërtimi i kapaciteteve në verilindje të Shqipërisë për trajtimin kirurgjikal të traumave dhe të personave të gjymtuar në mënyrë që të shërbejnë si kapacitete mjekësore të nivelit të dytë për të aksidentuarit nga minat.
- » Ndërtimi i kapaciteteve në verilindje të Shqipërisë për të përmirësuar cilësinë dhe aksesin në shërbimet sociale, mjekësore dhe rehabilituese.

Që nga dhjetori 2009, Shqipëria është shtet nënshkruar i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar e cila siguron një standart të ri për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë edhe të aksidentuarit nga minat/UXO. Plani i Veprimit i Kartagjenës mbi Asistencën për të Aksidentuarit, të cilin Shqipëria e firmosi në Samitin e Kartagjenës në dhjetor 2009, ndihmon vendet e prekura nga minat në forcimin e planeve egzistuese kombëtare për asistencën mjekësore dhe social ekonomike ndaj të aksidentuarve nga minat.

Aktivitetet:

- **Mbledhja e të dhënave** - Kryqi i Kuq Shqiptar dhe shoqata ALB-AID mbledhin të dhëna për incidentet dhe rifreskimin e databazës për vlerësimin e nevojave të personave të aksidentuar nga minat; të dhënat e mbledhura dërgohen në zyrën e AMAE-s dhe regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Veprimin ndaj Minave (IMSMA), dhe më pas shpërndahen tek partnerët e tjerë të programit. PNUD Shqipëri, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Demilitarizimit (NDC) dhe me financim nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (Dfid), ka mbledhur të dhëna (raportime incidentesh në IMSMA) të incidenteve nga minat dhe municionet e paplasura si rezultat i trazirave në vitin 1997. Kryqi i Kuq Shqiptar i ndihmuar nga Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar (ICRC) është duke mbledhur të dhëna për personat e aksidentuar nga municionet e braktisura në 12 prefektura në Shqipëri. Ka 686 persona të aksidentuar në të gjithë Shqipërinë nga municionet e braktisura (AXO). AMAE ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe mbështetjen për të aksidentuarit nga minat/UXO sidomos në rajonin e Kukësit.
- **Asistenca Mjekësore**—Janë bërë dy trajnime në shërbimin e urgjencës dhe ndihmës së parë në kuadër të Rrjetit me Bazë Komuniteti në periudhën 2004-2005



Pajisje për Spitalin e Kukësit



Reparti i Protezimit në Spitalin Rajonal të Kukësit



Donacion nga Bashkimi European në Spitalin e Tropojës

për 30 infermiere të cilat banojnë në fshatrat e ndotura me mina. Trajnimet u kryen nga specialistë të Institutit Silloven të Rehabilitimit më mbështetjen e PNUD-it dhe me fonde nga Departamenti i Zhvillimit Ndërkombëtar (Dfid), Departamenti për Parandalimin dhe Rikuperimin e Krizave (BCRP) dhe Departamenti Amerikan i Shtetit përmes ITF. U siguruan pajisje kirurgjikale për Spitalin Rajonal të Kukësit si dhe trajnime mjekësore për 7 specialistë, duke përfshirë kirurgë nga Spitali i Kukësit në vitet 2003, 2004 dhe 2009, të financuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit përmes ITF. Qeveria franceze bëri të mundur trajnimin në Institutin Silloven të Rehabilitimit për dy fizioterapistë të spitalit të Kukësit dhe Tropojës dhe për 6 infermiere nga fshatrat e ndotura nga minat si dhe siguroi pajisje dhe materiale mjekësore për fizioterapistët e spitalit të Kukësit dhe infermieret që punojnë në fshatrat e ndotura me mina.

- **Rehabilitim Fizik, Proteza dhe Mjete Ndihmëse** — ICRC ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve në Qendrën Kombëtare të Orto-Protezimit duke siguruar trajnim për teknikët dhe fizioterapistët si dhe materiale të lëndës së parë e asistencë teknike. Projekti mbi Rehabilitimin Mjekësor dhe Fizik (faza I dhe II), i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit nëpërmjet ITF ka si qëllim të ndërtojë kapacitete të qëndrueshme në zhvillimin e shërbimit të rehabilitimit në Shqipëri me anë të përfshirjes së programit të fizioterapisë në Fakultetin e Infermierisë në Tiranë si dhe me trajnimin e 7 teknikëve



Asistencë për të aksidentuarit në kuadër të projekteve për riintegrimin social - ekonomik

të protezimit në Shqipëri. Reparti i Protezimit pranë Spitalit të Kukësit i ngritur në mars 2005 me mbështetjen e Departamentit të Zhvillimit Ndërkombëtar (DfID), Zyrës për Parandalimin dhe Rikuperimin e Krizave të PNUD-it (BCPR), dhe Departamentit Amerikan të Shtetit ka riparuar protezat për 250 persona të amputuar ndërsa prej vitit 2007 janë prodhuar 50 proteza të reja. Prej vitit 2001, 140 të aksidentuar nga minat/UXO të klasifikuar si raste të vështira janë pajisur me proteza jashtë shtetit me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit nëpërmjet ITF. Trajnim periodik është siguruar për teknikët në Qendrën e Protezimit në Tiranë, Kukës dhe Pogradec. Infermieret pranë fshatrave të ndotura, fizioterapistët dhe neurologët nga Spitali i Kukësit janë pjesë e Rrjetit me Bazë të Komuniteti për të përmirësuar aksesin e të aksidentuarve nga minat në shërbimet mjekësore.

- **Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Qëndrueshmëria** – Janë trajnuar 6 mjekë specialistë, 7 teknikë të protezimit dhe 30 infermiere; është përmirësuar infrastruktura dhe janë siguruar pajisje të Qendrës Kombëtare të Orto-Protezimit dhe Repartit të Protezimit në Kukës. Një teknik i specializuar është kthyer në Qendrën Kombëtare të Orto-Protezimit pas një trajnimi 3-vjeçar jashtë shtetit si ISPO niveli II, duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetet e qendrës. Qëndrueshmëria është siguruar përmes një përfshirje të ministrive dhe spitaleve në planet e programit për të aksidentuarit nga minat.
- **Ndihmë psikologjike dhe Sociale** – Infermieret e trajnuara në kuadër të Rrjetit me Bazë Komuniteti sigurojnë këshillim për të aksidentuarit si dhe neurologu nga Spitali i Kukësit viziton tre herë në muaj të aksidentuarit nga minat.
- **Integrimi Socialo-Ekonomik** – Gjatë periudhës 2003–2009, 84 të aksidentuar nga minat dhe familjet e tyre janë asistuar për të krijuar ekonomi me bazë shtëpiake në blegtori përmes fondit qarkullues i zbatuar nga ALB-AID me fonde nga Departamenti Amerikan i Shtetit nëpërmjet ITF. Në periudhën 2006–2009, 95 të aksidentuar nga minat dhe familjarët e tyre u asistuan me trajnime profesionale dhe ndihmë financiare dhe teknike për të hapur biznesin e tyre të vogël me fonde nga Komisioni Evropian dhe SIDA nëpërmjet PNUD, si dhe me fonde nga Departamenti Amerikan i Shtetit përmes ITF.
- **Rehabilitimi dhe Ri-integrimi Arsimor** – Ambasada Amerikane në Tiranë, në bashkëpunim me PNUD/AMAE, ka organizuar pesë aktivitete të “Darkës së Një Mijë Gostive në Shqipëri”, një prej të cilave në bashkëpunim me Ambasadën Hollandeze. Donacionet u ofruan nga donatorë individualë dhe Biznesi Shqiptar dhe u dyfishuan nga Departamenti Amerikan i Shtetit nëpërmjet ITF. Aktivitetet e N1KD u zbatuan nga shoqata ALB-AID. “Dar-



Të amputuar duke marrë asistencë mjekësore në Institutin e Rehabilitimit Sloveni

ka e Një Mijë Gostive 2003" siguroi 16,275 USD të cilat u përdorën për të asistuar 5 fëmijë të aksidentuar nga minat në vazhdimin e mësimave, 5 të aksidentuar në ngritjen e ekonomive me bazë shtëpiake dhe 2 të dëmtuar nga sytë me trajtim mjekësor. "Darka e Një Mijë Gostive 2005" siguroi 21,958.50 USD, me të cilat u krye kontrolli mjekësor i 18 të dëmtuarve nga sytë dhe ndërhyrjen kirurgjikale për 10 të aksidentuar. "Darka e Një Mijë Gostive 2006" siguroi 16,870 USD të cilat u përdorën për të asistuar 8 të aksidentuar nga minat për të vazhduar studimet dhe rehabilitimin fizik të 2 të aksidentuarve nga minat. "Darka e Një Mijë Gostive 2007" siguroi 19,070 USD të cilat u përdorën për të asistuar 10 fëmijë të aksidentuar nga minat në vazhdimin e studimeve të tyre dhe kurseve profesionale. "Darka e Një Mijë Gostive 2009" siguroi 12,218 USD të cilat po përdoren për të asistuar 8 fëmijë të aksidentuar nga minat në vazhdimin e studimeve dhe kurseve profesionale deri në Qershor të vitit 2011.



Programi paralel i asistencës për të aksidentuarit nga minat mbajtur në Seminarin Rajonal të Tiranës për një Evropë Juglindore të Pastër nga Minat, Tetor 2009

- **Seminar Rajonal** - Një program paralel i ekspertëve për asistencën ndaj të aksidentuarve nga minat u organizua gjatë "Seminarit të Tiranës për një Evropë Juglindore të Pastër nga Minat" i mbajtur në 7-9 Tetor 2009 me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Njësisë Mbështetëse për Zbatimin e Konventës mbi Ndalimin e Minave kundër Personit (ISU). Pjesëmarrësit në seminar përfshinin përfaqësues nga vendet e prekura nga minat në Evropën Juglindore, të aksidentuar nga minat dhe municionet e paplasura, donatorë dhe organizata lokale dhe ndërkombëtare jo-qeveritare të cilat kanë kontribuar në veprimin ndaj minave në rajon. Programi Paralel i Veprimit ndaj Minave kishte si qëllim të theksonte sfidat dhe sukseset në përbushjen e të drejtave dhe nevojave të të aksidentuarve nga minat në rajon. Programi përfshinte diskutime mbi rehabilitimin mjekësor dhe fizik, ndihmën psiko-sociale dhe përmirësimin ekonomik të të aksidentuarve.

Planet për të ardhmen:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve për rehabilitimin mjekësor e fizik të të aksidentuarve nga minat/AXO dhe personave të tjerë me aftësi të kufizuara në nivel lokal dhe kombëtar.
- Zhvillimi i një programi të qëndrueshëm të rehabilitimit fizik dhe mjekësor në Shqipëri me përqëndrim në trajnimin për orteza.
- Vazhdimi i trajtimit dhe integritimit social-ekonomik të personave të aksidentuar nga minat/UXO dhe të familjeve të tyre përmes trajnimeve profesionale.
- Dhënia e ndihmës për përmirësimin e kapaciteteve të Qendrës Kombëtare të Orto-Protezimit për të siguruar më shumë akses dhe trajtim cilësor për të gjithë të amputuarit në nevojë në Shqipëri.
- Vlerësimi i detajuar i kushteve fizike, mjekësore dhe socio-ekonomike për 686 persona të aksidentuar nga Municionet e Braktitura të Paplasura (AXO) në Shqipëri.
- Kontributi në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar (2005-2015).



Darka e Njëmijë Gostive 2009

Ndihmë për fëmijët e aksidentuar me orë mësimi shtesë nga fondet e N1KD

KONTAKTE

Arben Braha

Drejtor AMAE
Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave
E-Mail: amaealbania@amae.org.al
Website: www.amae.org.al
Tel / Fax: + 355 4 2269 280; Mob. +355 69 20 94 629
Rr. "Donika Kastrioti" Pallati No. 14 Ap 3A
Tirana - Shqipëri

Dr. Arian Starova

Zevendes Minister i Mbrojtjes
Kryetar i Komitetit Shqiptar të Veprimit ndaj Minave (AMAC)
E-mail: asta@mod.gov.al
Tel: +355 4 240084 Fax: +355 4 225 227

Veri Dogjani

Koordinator i Asistencës
ndaj Viktimave dhe të Edukimit
Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave
E-Mail: mava@amae.org.al
Website: www.amae.org.al
Tel / Fax: + 355 4 2269 280
Rr. "Donika Kastrioti" Pallati No. 14 Ap 3A
Tirana - Shqipëri

Broshurë e rifreskuar, Nëntor 2010.
Design: CPR Production